



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 104/02-4209/22
Kaçanik, 28.02.2022

Në bazë të nenit 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Nr. 31/15 Qershor 2008) si dhe Ligjeve për ndryshim plotësimin e këtij ligji, Nr. 04/L- 111 të vitit 2012 dhe Ligjit Nr. 05/L -009 të vitit 2015, të nenit 5, 12.2(d) dhe 14 lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-040- Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Shkurt 2022, mori këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARVE TË KRM
“PASTËRTIA” SH.A-NJËSIA KAÇANIK

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A për Njësinë në Kaçanik.

2. Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A , përkatësisht për njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi, do t’i ketë 3 anëtarë : 1 (Një) anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2 (Dy)anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës, me këtë përbërje:

- 2.1. Bashkim Luma anëtar i KK nga subjekti politik i LVV;
- 3.2. Arlinda Rakoci -Raka anëtar i KK nga subjekti politik i LDK; dhe
- 3.3. Ramadush Osmani anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.

3 Detyrat e Komisionit Komunal të Aksionarëve janë të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare si dhe Ndryshim Plotësimet e këtyre ligjeve dy ligjeve.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

Me këtë Vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe përmes kësaj drejtorie njoftohet KRM “Pastërtia” SH.A-Ferizaj, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

DATA	11.03.2022
PËR/ZA/TO:	Z.Besim Ilazi, Kryetari i Komunës Kaçanikut
CC:	Znj.Venera Çerkini,zv.Sekretare e Përgjithshme/MAPL Z.Besim Myrtezani,zv.udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL Znj.Leonita Shabani,zv.Sekretare e Përgjithshme/ME Z.Xhevat Tafa,Udhëheqës i divizionit për Monitorim të Komunave Z.Gëzim Sahiti,zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave /MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Besim Imeri, udhëheqës i NJPMNP-së <i>Besim Imeri 11/3/2022</i>
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani,analiste/NJPMNP <i>Arbërore Bernica-Hasani</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Kaçanikut

I nderuar,

Në pajtim me Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, NJPMNP/ME ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut i miratuar me datë 28.02.2022, i pranuar në NJPMNP/ME nga MAPL me nr. prot.474 dt.09.03.2022 për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale KRM "Pastërtia" Sh.A Njësia Kaçanik, i miratuar nga Kuvendi dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon "Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me

shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar “

Ministria e Ekonomisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës si i tillë është në harmoni me legjislacionin aktual për ndërmarrje publike dhe mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!